

VENDIM
Nr. 618, datë 12.9.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 167, DATË 10.3.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË KUKËS,
TË QARKUT TË KUKËSIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Listës së inventarit, të miratuar me vendimin nr. 167, datë 10.3.2010 të Këshillit të Ministrave, t’i shtohen pronat me nr. 958 - 965 (nëntëqind e pesëdhjetë e tetë – nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë), gjithsej 1 (një) fletë, sipas lidhjes 1 dhe formularit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha